



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim B-A

Ngarkesa: 6kredite;15 leksione, 45 seminare; 60orë gjithsej

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I , Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Përvetësimi i njohuriveteorike dhe praktike në fushën e studimeve përkthimore dhe përkthimit. Aftësimi për të përcjellë një mesazh të shkruar në nga gjuha B në gjuhën A duke respektuar synimet, publikun e synuar si edhe objektivat e autorit, duke iu brendashkruar kritereve gjuhësore dhe regjistrin përkatës. Përvetësimi i një deontologjie personale nisur nga parimet e përgjithshme të etikës profesionale të profesionit të përkthyesit.

Analiza dhe formësimi i një gjykimi personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.Shkuarja drejt përsosjes së të kuptuarit të një teksti të shkruar në gjuhën B sikundër ndodh me folësin e lindur të asaj gjuhe. Analizë e të pathënës, aluzionit stereotipit, ndërtekstualitetit të një teksti. Identifikim i elementeve socio-kulturore të nënkuptuara në tekstin e shkruar. Përvetësim i teknikave dhe strategjive përkthimore të teksteve pragmatike nga gjuha frënge në gjuhën shqipePërvetësim i mjeteve për të kuptuar / riformuluar / rishikuar tekstin

Objektivat specifike lëndore: Studenti duhet të njohë se si të:

- Të përftojë njohuri ndërkulturore të dobishme për procesin e të kuptuarit, analizimit dhe kontekstualizimit të veprimtarisë përkthimore orientuar nga një qasje ndërkulturore.
- Të mobilizojë dhe zhvillojë njohuri tematike duke zbuluar temat kryesore të shoqërisë dhe kuptojë stilin dhe terminologjinë e brendshme në secilën prej temave në fjalë.
- Marrë stërvitjen e nevojshme për të zotëruar aftësitë redaktuese të nevojshme për përkthyesin në mënyrë që të jetë efektiv në treg.
- Përforcojë kompetencën redaktuese në gjuhën amtare.

Rezultate të pritshme:Në fund të modulit studentët do të jenë të aftë:

- Të përkthejnë me saktësi dhe profesionalizëm, drejt gjuhës shqipe, mesazhin e tekstit të hartuar në gjuhën burimore-frënge.
- Të zhvillojnë kompetencën e të reflektuarit në mënyrë kritike në lidhje me përkthimin dhe sfidat e tij;
- Të arsyetojnë, argumentojnë dhe sistemojnë njohuritë në fushën e përkthimologjisë;
- Të ushtrojnë mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ duke prodhuar një argumentim të arsyetuar në lidhje me ligjërimin e përkthimit, aktin e të përkthyerit;
- Të zbatojnë teorinë rast pas rasti në funksion të specifikave, llojit të tekstit dhe vështirësive përkthimore.
- Të përpunojnë materiale që lidhen me aspektet kognitive të procesit të përkthimit;
- Të përzgjedhin dhe referojnë bibliografi shkencore të mirëfilltë si edhe të ndërmarrin studime të mëtejshme autonome në punën shkencore.